# AKT THEMELIMI
# I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "CONSULTING PARTNERS" SHPK

Sot, ne Tirane, me date 12.09.2022, ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare” si dhe te Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” me vullnetin e tyre te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Statutit dhe te Akt Themelimit vendosen te formojne shoqerine:

## I. THEMELIMI

### <u>Neni 1</u>
### Ortaku themelues

1.1 Shoqeria **"CONSULTING PARTNERS"SHPK** themelohet nga ortaket:

- Z. Ermir VEIPI, shtetas shqiptare, lindur me 07.05.1976, ne Tirane dhe banues ne Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Medar Shtylla, Ndertesa 2, Hyrja 3, apartamenti 6, Tirane - Shqiperi, me numer karte identiteti H60507054P, i cili zoteron 75% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.

- Znj. Keida VEIPI, shtetase shqiptare, lindur me 10.06.1988, ne Tirane dhe banuese ne Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Medar Shtylla, Ndertesa 2, Hyrja 3, apartamenti 6, Tirane - Shqiperi, me numer karte identiteti I85610073G, e cila zoteron 25% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise

## II. EMRI. SELIA. FORMA LIGJORE

### <u>Neni 2</u>
### Emri i shoqerise

2.1 Emri i shoqerise eshte **"CONSULTING PARTNERS"SHPK**.

### <u>Neni 3</u>
### Forma ligjore

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (SHPK), ne baze te ligjit Nr.9901,date14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

### <u>Neni 4</u>
### Baza ligjore

**4.1** Shoqeria **"CONSULTING PARTNERS" SHPK**, do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Akt Themelimi, me Ligjin nr. 9901, date14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ” si dhe dispozitat e tjera te Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

### <u>Neni 5</u>
### Kohezgjatja

5.1 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje kohe mbi 10 vjet .

5.2 Veprimtaria e Shoqerise fillon qe nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit,Tirane.

### <u>Neni 6</u>
### Selia

6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen:, Njesia bashkiake nr.5, Rruga Komuna e Parisit, Pallati Niku

Konstruksion, kati 7, ap.61, Tirane – Shqiperi.

6.2 Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakeve te shoqerise.

6.3 Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale ose/dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte vendit.

6.4 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera ekzistuese ose ne shoqeri qe ne te ardhmen do te zhvillojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij me vendim te ortakeve te saj.

**Neni 7**
**Vula**

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret nga administrator/administratoret.

7.2 Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Ortakeve te shoqerise, ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

**Neni 8**
**Objekti**

8.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

1. Auditues Ligjor dhe sherbime te lidhura me te.
2. Sherbime auditimi,sherbime rishikimi, sherbime te tjera te sigurise dhe sherbime te lidhura sipas percaktimeve te bera per to nga Federata Nderkombetare e Kontabilisteve.Sherbime Kontabiliteti dhe te lidhura. Sherbime ristrukturimi dhe operacione te vecanta te shoqerive tregtare,lidhur me ndarjen, bashkimin, perthithjen, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit dhe likuidimin;Konsulence ekonomike, financiare dhe fiskale per shoqerite tregtare, personat fizike, individe dhe organizata te tjera, te njohura nga legjislacioni ne fuqi. Sherbime ligjore ne fushen tregtare, fiskale dhe kontabile, ekspertize kontabile,analiza financiare dhe fiskale per llogari te institucioneve publike dhe private, sipas kerkeses.Sherbime si perfaqesues tatimor dhe perfaqesim te paleve te treta, sipas percaktimeve ligjore. Vleresime te aktiviteteve tregtare, vleresime te pasurive te luajtshme, te paluajtshme, aktive te tjera materiale dhe jomateriale. Pergatitje plan biznesi, buxhetime dhe analiza financiare, studime tregu, studime fizibiliteti etj.
3. Keshillim ne drejtim te personave juridike dhe entiteteve te llojeve te ndryshme (SME, etc.),me synim rritjen dhe permiresimin e performances se tyre, perfshire drejtim strategjik,ndertim strukturash organizative, sekondim stafi ne pozicione pune drejtuese, afatgjate dhe afatshkurter, keshillim ne fushen e marketingut etj; keshillim ne fushen e analizes institucionale, drejtimit financiar, kontabel dhe fiskal, analize financiare, kryerja e kerkimeve dhe studimeve ekonomike, ndertim planesh biznesi per cdo fushe te ekonomise, si per organizata biznesi dhe organizata jo fitimprurese; hartim te aplikimeve, planeve te biznesit me qellim perthithjen e financimeve; konsulence ne ri-inxhinjerim financiar dhe perfaqesi me pale te treta, manaxhim te situatave te veshtira dhe ristrukturim te kompanive; sherbime konsulence per futjen ne treg te kompanive te ndryshme (kryesisht ne sektorin agroushqimor, edukim, energjitike, sherbime financiare, etj); vleresim i shoqerive tregtare (procesi i due dilligence) me qellim identifikimin e problemeve dhe permiresim te treguesve me qellim realizimin e objektivave dhe aplikimin e strategjise; konsulence ne krijimin e aktiviteteve te reja tregtare (startup-s), keshillim per mire-administrim te ideve dhe aktivitetit tregtar, ngritje kapitali dhe financim; keshillim per krijim te instrumentave financiare; investim ne tituj; mbeshtetje drejtuese, teknike dhe operacionale ne vleresim, manaxhim dhe implementim projektesh dhe programe zhvilluese; referimi per sherbime financiare prane institucioneve financiare, tregjeve alternative dhe investitoreve;
4. Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem shqiptar.

8.2 Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 9**
**Kapitali**

9.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000(njeqindemije) leke, i nenshkruar dhe pagesa e tyre eshte bere ne kesh ne arken e shoqerise.

9.2 Kapitali eshte i ndare ne 2(dy) pjese(kuota), dhe zoterohet nga:

1. Z.Ermir Veipi i cili zoteron 1 kuote dhe 75% te pjesemarrjes se kuotave ne kapital e cila ne vlere leku eshte 75,000 leke(shtatedhjete e pese mije leke).
2. Znj.Keida Veipi e cila zoteron 1 kuote dhe 25% te pjesemarrjes se kuotave ne kapital e cila ne vlere leku eshte 25,000 leke(njezete e pese mije leke).

**Neni 10**
**Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar**

10.1 Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

10.2 Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen edhe te treteve me vendim te ortakeve te shoqerise. Pjeset e kapitalit transferohen ne rruge trashegimnie pasi te jete marre Vendimi i Ortakeve vetem lidhur me kalimin e pjeseve te kapitalit tek trashegimtaret.

**Neni 11**
**Zmadhimi/Zvogelimi i kapitalit themeltar**

11.1 Ortaket e shoqerise mund te zmadhojne ose zvogelojne kapitalin themeltar me vendim te tyre. Zvogelimi i kapitalit themeltar do te kryhet brenda kufijve te lejuar nga ligji.

## 2. ORGANET E SHOQERISE

**Neni 12**
**Asambleja e Ortakeve**

12.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise.

12.2 Asambleja e Ortakeve drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve. Mbledhjet e Asamblese jane te zakonshme.

**Neni 13**
**Asambleja e Zakonshme**

13.1 Asambleja e zakonshme vendos ne cdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo merr te gjitha vendimet (emerimi dhe shkarkimi i administratorit/eve, miratimin e bilancit te shoqerise, etj.) me perjashtim te atyre vendimeve qe ne baze te Ligjit ose Statutit jane ne kompetence te Asambese se Jashtezakonshme.

13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortaket e saj me 51% te votave.

**Neni 14**
**Thirrja dhe Perfaqesimi ne Asamble**

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve mund te thirret ne cdo kohe nga:

- Administratori/Administratoret;
- Ortaket e shoqerise.

-E te tjere konform ligjit

**Neni 15**
**Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve**

15.1 Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te njoftuar nga administratori/njeri prej administratoreve.

15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes dhe permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

**Neni 16**
**Marrja e vendimeve**

16.1 Vendimet merren nga ortaket e saj me 51% te votave.

**Neni 17**
**Administrimi**

17.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratoresh qe caktohet nga Asambleja e Ortakeve.

17.2 Administratori/ret nuk eshte detyrimisht ortak i shoqerise.

17.3 Administratoret veprojne ne menyre te pavaruar.

17.4 Administratori/ret kane te drejte te perfaqesoj shoqerine dhe te drejtoj punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Asamblese se Ortakeve.

- Administratori eshte solidarisht pergjegjes per veprimtarite e meposhtme:
- drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
- perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendes.
- perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendes, veçanerisht ne marredheniet me bankat e nivelit te dyte dhe institucionet e tjera te kreditit, per hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
- pergatitjen e mbledhjeve te Asambleve te Ortakeve;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vete ose emerimin e nje kontabilisti te miratuar ose te nje eksperti kontabel;
- pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe ka;
- lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
- Zhvillon veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te saj.

17.5 Shoqeria do te administrohet nga dy administratoret te cilet jane:

- znj.Keida VEIPI e cila emerohet ne kete detyre per nje afat kohor prej 5(pese) vjet i cili fillon me 12.09.2022 deri me 11.09.2027.
- z. Ermir Veipi i cili emerohet ne kete detyre per nje afat kohor prej 5(pese) vjet i cili fillon me 12.09.2022 deri me 11.09.2027.

**Neni 18**
**Viti financiar**

18.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

**Neni 19**
**Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**

19.1 Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve dhe I paraqitet organeve tatimore deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.
19.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.
19.3 Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

**<u>Neni 20</u>**
**Te ardhurat. Dividendi**

20.1 Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.
20.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, mund te terhiqen nga ortaku I vetem i shoqerise.

**<u>Neni 21</u>**
**Likuidimi**

21.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:
- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Asambleja e Ortakeve, vendos te prishe shoqerine.

21.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Asambleja e Ortakeve emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh.
21.3 Likuidatori/likuidatoret raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivit dhe te pasivit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e Ortakeve shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

**<u>Neni 22</u>**
**Dispozita mbyllese**

22.1 Ky Akt Themelimi hartohet ne 2 (dy) kopje me fuqi te njejte ligjore ne gjuhen Shqipe.

**ORTAKET E SHOQERISE**

| **ERMIR VEIPI** | **KEIDA VEIPI** |
|---|---|
| Ermir Veipi | KEIDA VEIPI |

**Tirane, me 12.09.2022**